



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **20.05.2025**, me fillim në orën **10:15**.
Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar i komunës, **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen e **pestë (5)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01022-0, ZK-Hoçë e Madhe;
3. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01022-0, ZK-Hoçë e Madhe;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01830-0, ZK-Rahovec - Respektivisht lokali te parku i qytetit;
5. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01830-0, ZK-Rahovec - Respektivisht lokali te parku i qytetit;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, këtë rend dite e vendosim në votim, kush është “për”?... Unanimisht (5) votohet rendi i ditës për mbledhjen e pestë të KPF-së.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht (5) aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01022-0, ZK-Hoçë e Madhe:

Nënkryetari: Faleminderit i nderuar kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të KFOR-it. Para vetes e keni vendimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vite, pastaj në kuvend do ta përcaktoni për sa vjet. Prona gjenden në Hoçë të Madhe. Nga sipërfaqja e përgjithshme prej 9574m², jepen në shfrytëzim 3000m² ose 30 ari, për të vazhduar me procedurat e tjerat të ankandit publik.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! A kemi diçka lidhur me këtë pikë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht (5) aprovohet edhe pika e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01022-0, ZK-Hoçë e Madhe:

Nënkryetari: Pika e tretë ka të bëjë me komisionin, i cili votohet në kuvend dhe formalisht duhet të kalojë edhe në KPF.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! A kemi diçka lidhur me këtë pikë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatohet me shumicë votash (4) aprovohet edhe pika e tretë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01830-0, ZK-Rahovec - Respektivisht lokali te parku i qytetit:

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, anëtarë të KPF-së, përfaqësues të KFOR-it. Para jush kemi propozimin e kryetarit për dhënien në shfrytëzim lokal, i cili gjendet te parku i qytetit – te shtatorja e dy heronjve “Tonin e Mici”. Bëhet fjalë për kafiterinë 01830-0, me sipërfaqe prej 132m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5813m². Jepet në shfrytëzim për periudhën 5 vjeçare. Qëllimi ka të bëjë me ruajtjen dhe rritjen e vlerës së pronës komunale. Sipas certifikatës së pronësisë, kjo pronë edhe pronë e komunës së Rahovecit.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Fillimisht ju kërkoj falje për vonesën! Përshëndetje për nënkryetarin, drejtorët, kolegët, KFOR-in. Drejtor, a ka përfunduar kontrata, apo po ndërprehet?

Erhan Morina: Realisht ky lokal ka kontratë deri më 30 dhjetor të këtij viti, por për shkak që është vit zgjedhor dhe mos të krijohen një “hendek” dhe mos të mbetet pa qera, kemi vendosur që procedurat t’i zhvillojmë tani. Gjithashtu është rekomandim i auditorit. Në kontratë do të ceket një nen që, kontrata hyn në fuqi pas datës 31 dhjetor.

Defrim Kafexhiu: Përshëndetje për të gjithë! Drejtor, prona jepet në shfrytëzim përmes ankandit publik dhe qeramarrësi ose ai që është duke e shfrytëzuar pronën publike nëse investon, a ka ndonjë form ligjore që i njëjti ka përparësi, kur e dimë që në ankand mund ta marrë dikush pavarësisht investimit që e ka bërë dikush tjetër dhe që e ka momentalisht në shfrytëzim. Si përcaktohen kriteret sipas ligjit? Është pyetje edhe për pronat publike tjera.

Erhan Morina: Faleminderit Defrim! Në të kaluarën, sipas ligjit ka qenë praktikë për personat që e kanë në shfrytëzim t’i kenë me automatizëm 5 ose 10 pikë, ndërsa tani sipas ligjit kjo e drejtë është mohuar. Të gjithë janë në kushte të barabarta, kushdo që e jep ofertimin më të mirë. Përndryshe, në kontratë ceket që çdo investim që bëhet nga investitori, në fund të periudhës asetet i mbeten komunës.

Defrim Kafexhiu: A ka ndonjë formë që, një pronë publike nëse është në shfrytëzim dhe e ka një kontratë 5-vjeçare, a ka formë tjetër që mund t’i shtohet afati për shfrytëzim të asaj pronë, në mënyrë që mos t’i nënshkrohet përsëri ankandit. Meqenëse ligji e mohon përparësinë në ankand, tash është në pyetje nëse dikush i investon 100.000€, kontratën e ka për 5-vjet dhe e bën një planifikim, pas 5 viteve ndryshojnë rrethanat – hyn dikush tjetër në ankand dhe e jep një çmim më të mirë, a është kjo diskriminim? A ekziston ndonjë mënyrë që në raste të tilla komuna t’ia vazhdojë afatin atij, nëse ai ka qenë i rregullt me pagesa?

Erhan Morina: Jo Defrim, realisht ligjin nuk e lejon që t’i vazhdohet kontrata pas skadimit. Në momentin kur përfundon kontrata gjithçka fillon prej zëros.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A kemi diçka lidhur me këtë pikë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatohet me shumicë votash (5) aprovohet edhe pika e katërt e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01830-0, ZK-Rahovec - Respektivisht lokali te parku i qytetit:

Kryesuesi: Sa i përket pikës së pestë, ka të bëjë me komisionin, i cili zbaton procedurat kur jepet në shfrytëzim kjo pronë komunale. Komisioni zgjedhet në kuvend. E vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatohet me shumicë votash (6) aprovohet edhe pika e pestë e rendit të ditës.

6. Të ndryshme:

Burim Krasniqi: Meqenëse në seancën e fundit dhe ndonjëherë po praktikohet që t'i kemi përgjigjet me shkrim. E para, kërkoj që pavarësisht se cili asambleist bën pyetje, përgjigjet të shkojnë te të gjithë asambleistët. E dyta: I kam tri pyetje që pres të marr përgjigje në seancë. Rreth drejtorëve të shkollave, disave u është vazhduar mandati, disa iu kanë nënshtruar konkursit. Kërkoj që të na përcjellni raportin e vlerësimit. A janë bërë vlerësimet e drejtorëve ndërvite dhe pse dikujt i vazhdohet e dikujt jo? Çerdhja në Xërxë, dy javë ka qenë pa rrymë! Cila është arsyeja? Sa fëmijë i ka çerdhja në Krushë, si dhe sa edukatore punojnë? E fundit, nëse mund ta kemi si informatë se sa janë shpenzuar mjete në transport dhe në ushqim këtë vit, për të moshuarit që qëndrojnë në shtëpinë e të moshuarve te Maja e Shkodranit?

Defrim Kafexhiu: E kam një kërkesë ose një propozim për Drejtorinë e Inspekcionit: Në seancën e rregullt të na informojë për punën e kësaj drejtorie përgjatë kësaj periudhe. Secili jemi të vetëdijshëm për punën e ndërtimeve pa leje dhe gjithmonë komuna dhe drejtoria është arsyetuar në mungesë të inspektorëve. Nëse mund ta kemi si informatë në seancë se sa punë kanë kryer këta inspektorë që janë. Propozoj një pikë shtesë të rendit të ditës për në seancën e rregullt. Të diskutohet për dy lagje: “Vëllezërit Frashëri” dhe për “Lagjen e Epërme”, rreth sigurimit të një pjese të parcelës për trafo elektrike. Është e dhimbshme që gjatë gjithë mandatit, komuna nuk ka mundur të sigurojë një pronë të vogël, sepse për vendosjen e një trafos elektrike nevojiten 9m². Besoj që do të ishte çështje e mirë diskutime dhe ta gjejmë formën që atyre t’ju ofrojmë zgjidhje, qoftë shpronësimit apo këmbimit. Pra, t’i shqyrtojmë të gjitha format ligjore, se si komuna mund ta sigurojë një sipërfaqe të vogël për vendosjen e trafos. Është e domosdoshme dhe i ftoj kolegët anëtarë të KPF-së që ta votojnë këtë propozim timin.

Nënkryetari: Faleminderit për këto pyetje – konstatime. Rendi i ditës për seancën e kuvendit shpërndahet sot, eventualisht nesër dhe nëse kërkon informatë në Drejtorinë për Punën Inspektuese, informata nuk mund të bëhet, përveç nëse materiali t’ju shpërndahet aty për aty. Do të bisedojmë me drejtoreshën për përgatitjen e kësaj informate, por si pikë e rendit të ditës nuk besoj që mund të trajtohet në këtë seancë, për arsye të shpërndarjes së materialit – punëve tjera që mund t’i kenë ata. Te çështja e trafos, te lagjja “Te Rrasat” dhe te lagjja ku ju banoni, “Vëllezërit Frashëri”, aty kam qenë vet prezent kur një bashkëvendas i yni që jeton jashtë, Agim Kastrati, është deklaruar me vullnetin e tij dhe tani po e kundërshtojnë. Komuna e ka kryer obligimin dhe të gjitha procedurat dhe tani ai apo familjarët e tij nuk e lejojnë vendosjen e trafos. Dje, personalisht kam marrë iniciativë dhe në po të njëjtën rrugë 200-300 m më larg, e kam autorizuar drejtorin e Kadastrës që ta sheh nëse ekziston ndonjë mundësi në mënyrë që mos të dështojë ky projekt. Unë vet kam qenë drejtor i Kadastrës dhe përgjatë asaj vije rrugore, asnjë metër rrugë publike nuk është. Te pronat private që janë, e dini që asgjë nuk bëhet me zor, por vetëm me vullnetin e palëve. Te lagjja tjetër “Rrasat”, ju e dini që atje prej KEDS-it ka ndodh një investim dhe është përforcuar rryma sado pak. Atje e kam bërë një propozim, nëse eventualisht mund të ndahet ndonjë hapësirë e vogël për vendosjen e trafos përgjatë rrugës tranzit të UÇK-së dhe nëse mund të vendoset pikërisht aty, për shkak të distancës të shtëpive. Përndryshe, komuna i ka kryer të gjitha procedurat sa i përket hapësirave për vendosjen e trafos. Sa i përket pyetje të Burimit për drejtorët: ligji është ai që ia mundëson dhe nëse ligji e lejon që drejtorit t’i vazhdohet mandati mbi bazën e performancës, atëherë është në rregull. A mund të kontestohet? Po, prej aplikantëve, me anë të një ankese që ligjërisht u takon. Mund të kërkon qasje në dokumente publike dhe t’i shihni të gjitha. Te ushqimi dhe transporti te shtëpia e pleqve, mund të sigurohet informata rreth kësaj pyetje. Për shkak të mosinteresimit është ndërprerë edhe transporti edhe ushqimi. Së fundi është mbajtur një simpozium i artit aty, më datë 09-10-11 maj.

Burim Krasniqi: Nënkyetar, faleminderit shumë për diskutimin dhe tendencën për elaborim, por ne ju drejtuam diçka që është konform rregullores për funksionimin e asamblesë komuna dhe nuk besoj që është në kundërshtim as me Statutin e komunës. Nuk gjykova në punën e komisionit, as në të drejtën e kryetarit të komunës dhe drejtorit për rishpallje apo jo. Kërkova informata dhe nëse kërkohet që t'i keni raportet e performancës së drejtorëve të shkollave për vazhdimin e mandatit ose për rishpallje të konkursit, drejtori këto duhet t'i ketë në sirtarin e vet. Besoj që nuk është sfiduese që informata të përpilohet në dy faqe. Pres që në seancën e radhës të kem përgjigje, ose të thoni që është kërkesë joligjore dhe nuk mund të përgjigjeni.

Nënkyetari: Kërkesat e asambleistëve si kjo nuk kanë lidhje me "ligjore" apo "joligjore". Kërkesat mund të jenë të arsyeshme ose të paarsyeshme. Të gjitha punët e ekzekutivit janë publike dhe nuk ka asgjë sekrete. Nëse dikush heziton, sipas ligjit është qasja në dokumente publike. Mos të harrojmë faktin që në disa informata të Drejtorisë së Arsimit, ti ke kërkuar që informata të jetë më e plotë dhe unë të kam përkrahur. Unë jam 100% me ty dhe secilin asambleist për këto informata. Për pjesën tjetër "ligjore" apo "joligjore" janë organet tjera që i trajtojnë.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit për sqarimet nënkryetar! Respekt për aktivizimin në diskutime. Kam qenë i njoftuar me qytetarin që ka qenë i gatshëm për atë hapësirë për shpronësi. Këtu është një problem, sepse ajo sipërfaqe e vogël nuk mund të këmbehet në vlerë të mjaftueshme për dikë që dëshiron ta jep. Komuna ndoshta do ta kishte më të arsyeshme, që me një vendim të kuvendit ta shtojë vlerën e të hollave për një qytetar që dëshiron ta jep një pjesë të parcelës për çështjen e trafos. Besoj që, do të ishte shumë mirë që të jetë si pikë e rendit të ditës për seancën e rregullt kjo çështje, sepse mund të ketë ide më kreative që është në të mirë të komunës dhe qytetarëve, si dhe problemi të zgjidhet më shpejt. Nëse është mundësia me që rendi i ditës nuk është i ngarkuar, ta vendosim këtë pikë në rend dite. Nuk dyshoj në vullnetin e komunës për ta zgjidhur problemin me trafo edhe te lagjja "Vëllezërit Frashëri" edhe te lagjja "Rrasat", por hapat që duhet t'i marrim duhet të bëhemi bashkë në kuptim që ta japim maksimumin, sepse sidomos për lagjen tonë ky problem është shumë i madh.

Nënkyetarin: Të aktivizohem edhe më shumë! Nuk ka qenë fare në diskutim vlera e shpronësimit, që pronari aktual e jep për ndërtimin e trafos. Janë disa telashe të tjera, "pse të vendoset trafoja, ndoshta ka rrezik" etj... Përndryshe, në Ministri të Financave ekziston një department për shpronësime dhe ata e përcaktojnë vlerën. Nuk e di ligjërisht sa mundemi që ne si komunë edhe një herë ta shpronësojmë të njëjtën pronë. Nuk besoj që mund të ndodh, sepse ligjërisht të njëjtat prona nuk besoj që mund të vlerësohen - prej ministrisë dhe prej komunës. Une e di sakt se si qëndron puna me rrymë te ju. I kemi disa kurbetqarë që vinë këtu, investojnë dhe i vendosin pajisjet për nxemje qëndrore dhe në fund te nishi nuk funksionon, sepse tensioni është i dobët.


Burim Krasniqi: Ndoshta është më mirë që në një seancë, Drejtoria e Gjeodezisë ta ketë një propozim konkret. Mos harroni një gjë, për ta ndërtuar një objekt banimi duhet ta marrim një pëlqim prej KEDS-it. Kur e vendosim trafon me tension të lartë, e krijojnë një obligim që ta mbajmë distancën prej telave deri te vija ndërtimore. Kjo ia kufizon mundësinë e shfrytëzimit të parcelës. Një qytetar, që ndoshta është i gatshëm ta falë krejt, por kur dalin telasht tjera që ai duhet të largohet nga tensioni i lartë, ai e redukton mundësinë e sipërfaqes për ndërtim. E keni në konsideratë. Pajtohemi plotësisht me kërkesën e Defrimit. Drejtoria e Kadastrës le ta shohë mundësinë e hapësirës, sepse nuk do të thotë patjetër në atë rrugë, trafoja mund të jetë më larg dhe të zgjaten kabllot. Ta bëjmë një zgjidhje të duhur dhe mos ta marrim një vendim të dytë që përsëri të bëhemi "pishman", sepse mund të përsëritet si cilëk dhe dalim joserioz në këtë çështje. Prej sallës po flas kot për problemet atje, sepse nuk e njohim gjendjen më mirë se Drejtoria e Kadastrës dhe gjeodetët që i ka brenda.

Nënkyetari: E njoh shumë mirë problematikën aty prej që kam qenë unë drejtor i kadastrës. Jemi munduar edhe me një pronar atje, e kemi gjetë pronën, por në fund nuk është realizuar. Nuk e kontestoj vullnetin e gjithsecilit që ta ndihmojë këtë proces, por prej QKMF-së deri atje lart nuk është asnjë metër pronë publike.

Duhet t'i lusim pronarët privat për një vend të përshtatshëm. E kemi gjetë pronën, i kemi përfunduar procedurat dhe në fund të thotë jo, për shkak të kësaj e kësaj... Jemi duke pritur nga KEDS-i se a mund të vendoset kjo trafo në rrugën tranzite UCK apo jo? Nëse mund të bëhet, atëherë kjo trafo do t'i mbulojë të dyja lagjet. Nëse kjo ndodh neve na shpëton, sepse aty ka pronë publike dhe mund të ndahen 2-3 hapësira. E gjitha kjo, në mënyrë që ky proces të ndodh në planin investiv të KEDS-it, nëse ik do të ik pa fajin tonë, por në mungesë të hapësirave publike që kemi. Secili që e njih dikë që e shpreh një gatishmëri të vogël, ne jemi në gjendje 24 orë të diskutojmë, në mënyrë që ta zgjidhim këtë problem.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, ju informoj që në mbledhjen e kuvendit e kemi edhe një pikë shtesë. Ju falënderoj për vëmendjen dhe shihemi në mbledhjen e rregull të kuvendit.

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi



KRYESUESI


Arbër Zenuni

